

OTTO - AL

General Construction & Mineral Processing

Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit te Pavarur

OTTO – AL Sh.p.k

31 Dhjetor 2018

Permbajtja

	Faqe
RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCES	4
PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL	6
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE	7



Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Ortakun e Shoqërisë Otto-Al Sh.p.k,

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë Otto-Al Sh.p.k (më poshtë “Shoqëria”) që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2018, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, dhe një përmbledhje të politikave kontabël dhe informacione të tjera sqaruese, të përfshira nga faqja 3 deri në faqen 18.

Sipas opinionit tone, përveç efekteve të mundshme të çeshtjes se diskutuar në paragrafin “Baza për opinionin me rezervë”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejte, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Otto-Al Sh.p.k më 31 dhjetor 2018 si dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në ato date, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Baza për Opinionin me Rezerve

Siç është paraqitur në Shënimin 4 të pasqyrave financiare më 31 Dhjetor 2018 vlera e llogarive të arketueshme është 106,386 mijë Lekë. Shoqëria nuk ka kryer një vlerësim për mundësinë e arkëtimit të vlerës së llogarive të arketueshme dhe njohjen e humbjeve për borxhin e keq.

Siç është paraqitur në Shënimin 5 të pasqyrave financiare më 31 Dhjetor 2018 vlera e llogarive të tjera të drejta të arketueshme është 85,2890 mijë Lekë. Shoqëria nuk ka kryer një vlerësim për mundësinë e arkëtimit të vlerës prej 71,298 mijë dhe njohjen e humbjeve për borxhin e keq.

Siç është paraqitur në Shënimin 6 të pasqyrave financiare më 31 Dhjetor 2018 vlera e inventarit është 108,332 mijë Lekë. Ne nuk kemi vëzhguar inventarizimin fizik të inventarit më 31 Dhjetor 2018 meqenëse kjo date kane qenë para se ne të angazhoheshim si auditues të Shoqërisë.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit Ndërkombëtar për Standardet e Etikës (Kodi i IESBA) dhe Kodit të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (Kodi i IEKA), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të amenduar, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e njafatueshme dhe e përshtatshme dhe shërben si bazë për opinionin tonë të kualifikuar (me rezerve) të auditimit.

TPA Albania shpk

Rr.Reshit Collaku, Pall.Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Albania

www.tpa-group.com

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen Për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, për shënimet shpjeguese për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuodojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveç sa më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiar

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontroleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.

TPA Albania shpk

Rr.Reshit Collaku, Pall.Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Albania

www.tpa-group.com

- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë Otto –Al shpk, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Date 28 qershor 2019


Ilir Binaj CPA, CGMA, Auditorues i Lirë



TPA Albania shpk

Rr.Reshit Collaku, Pall.Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Albania

www.tpa-group.com


Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2018
(në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënimet	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
AKTIVET			
Mjetet monetare	3	33,910,255	45,740,225
Llogari te arketueshme	4	106,386,582	190,795,182
Te tjera te drejta te arketueshme	5	85,289,555	82,740,299
Inventari	6	108,332,665	114,343,816
Totali i aktiveve afatshkurtra		333,919,057	433,619,522
Aktive afatgjata materiale, neto	7	108,611,230	107,060,960
Investime ne shoqëri të tjera	8	35,125,600	5,200,000
Totali i aktiveve afatgjata		143,736,830	112,260,960
TOTALI I AKTIVEVE		477,655,887	545,880,482
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Furnitore	9	119,363,509	224,691,944
Detyrime ndaj punonjesve, sigurime etj	10	1,421,345	1,331,784
Te tjera te pagueshme	11	735,607	2,634,001
Totali i detyrimeve afatshkurtra		121,520,461	228,657,730
Huamarrje afat-gjate	12	68,400,249	37,545,249
Totali i detyrimeve afatgjata		68,400,249	37,545,249
Totali i detyrimeve		189,663,338	266,202,979
Kapitali i regjistruar	13	270,000,000	136,800,000
Rezerva te tjera		9,213,686	120,439,739
Fitimi i akumuluar		8,521,491	22,438,125
Totali i kapitalit		287,735,177	279,677,504
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		477,655,887	545,880,482

Pasqyrat financiare jane aprovuar nga drejtimi i Shoqërise me 29 Mars 2019 dhe firmosur ne emer te saj nga:

Isuf Berberi
Administrator



Shih shenimet shpjeguese qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2018
(në Lek)

Pasqyra e Performancës

	Shënimet	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Te ardhura			
Te ardhura nga veprimtarite e shfrytezimit	14	63,172,541	158,304,004
Te ardhura te tjera	15	16,380,408	17,928,623
Totali I te ardhurave		79,552,950	176,232,627
Kostot operative			
Materialet e konsumuara	16	-36,996,570	-120,420,204
Shpenzime per personelin	17	-16,233,951	-15,676,175
Zhvleresim dhe amortizim	7	-6,148,179	-5,876,089
Shpenzime administrative dhe te tjera	18	-7,322,842	-5,690,043
Totali i shpenzimeve operative		-66,701,541	-147,662,512
Fitimi/(humbja) neto nga operacionet		12,851,409	28,570,115
Te ardhura/(shpenzime) financiare, neto	19	-2,727,782	-2,168,281
Te ardhura/(shpenzime) nga interesi, neto	19	-95,013	-
Fitimi para tatimit		11,368,209	26,401,834
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	20	-1,507,122	-3,963,710
Fitim/(humbja) per vitin		8,521,491	22,438,125

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2018
(në Lek)

Pasqyra e flukseve monetare

	Shenime	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Fluksi monetar nga veprimtaria e shfrytezimit			
Fitimi/(humbja) para tatimit		8,521,491	22,438,125
Rregullime per:			
Zhvleresimi i aktiveve afatgjata material	7	6,148,179	5,876,089
Fitimi nga veprimtarite e shfrytezimit para rregullimeve ne kapitalin punues		14,669,670	28,314,214
(Rritje) / ulje e llogarive te arketueshme dhe te tjera		81,859,344	-109,011,658
(Rritje) / ulje e inventareve		6,011,151	81,608,839
Rritje /(ulje) ne furnitore dhe te tjera detyrime		-103,796,987	12,028,973
Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit		-1,256,821	12,940,367
Tatimi mbi fitimin i parapaguar		-3,340,282	-
Fluksi monetar neto nga veprimtarite e shfrytezimit		-4,597,103	12,940,367
Fluksi monetar nga veprimtarite e investimit			
Blerja e aktiveve afat-gjata	7	-7,698,449	-4,128,658
Investime ne shoqëri të tjera		-29,925,600	-
Fluksi monetar neto i gjeneruar nga/ (perdorur ne) veprimtarite e investimit		-37,624,049	-4,128,658
Fluksi monetar nga veprimtarite financiare			
Arketime (Pagesa) nga hua-marrja afatgjate		30,855,000	-
Arketime (Pagesa) nga rivleresimet		-463,816	-
Fluksi monetar neto i gjeneruar nga/ (perdorur ne) veprimtarite financiare		30,391,184	-
Rritja/(ulja) neto e mjeteve monetare		-11,829,969	8,811,708
Mjete monetare me 1 Janar		45,740,224	36,928,516
Mjete monetare me 31 Dhjetor	3	33,910,255	45,740,225

Shih shenimet shpjeguese qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2018
(në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital

	Kapitali i Regjistruar	Rezerva te tjera	Fitimi i Akumuluar	Totali
Gjendja me 01 Janar, 2017	136,800,000	85,948,742	7,372,556	230,121,298
Fitimi i periudhes	-	-	22,438,125	22,438,125
Rezerva nga Rivleresim Apartamenti	-	27,118,081	-	27,118,081
Rritje (zvogelim) rezervash	-	34,490,637	-34,490,637	-
Gjendja me 31 Dhjetor, 2017	136,800,000	147,557,460	- 4,679,957	279,677,504
Gjendja me 01 Janar, 2018	136,800,000	147,557,460	-4,679,957	279,677,504
Fitimi i periudhes	-	-	8,521,491	8,521,491
Ulje e Rezerves nga fatura	-	-463,818	-	-463,818
Rritje kapitali	133,200,000	-133,200,000	-	-
Rritje (zvogelim) rezervash	-	22,438,125	-22,438,125	-
Gjendja me 31 Dhjetor, 2018	270,000,000	9,213,686	8,521,491	287,735,177

Shenimet e pasqyrave financiare

1. Informacion i pergjithshem

Otto - Al sh.p.k (“Shoqeria”) është krijuar me daten 23 Shkurt 1999. Selia e Shoqërisë është në Rruga Elbasanit, Prane Fakultetit Gjeologjik, Tiranë, Shqipëri. Shoqeria është regjistruar në autoritetet fiskale me Numer Identifikimi të Personit të Tatuësëm (NIPT) J92009003W.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është ndërtimi publik, punët civile, shfrytëzimet minerale, dhe transporti publik .

Administrator i Shoqërisë është Z. Isuf Berberi. Më 31 Dhjetor 2018 shoqeria kishte 17 punonjes (31 Dhjetor 2017: 21 punonjes).

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2018 janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqërisë me 28 Mars 2019.

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

2.1 Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standartet Kombëtare të Kontabilitetit që janë të përfshira në ligjin Nr 9228 datë 29 Prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ndryshuar me ligjin Nr 9477 datë 09.02.2006 dhe me urdhrin e Ministrit të Financave Nr 65 datë 5.05.2008 dhe në përputhje me politikat kontabël të shoqërisë.

Keto pasqyra financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike dhe parimin e biznesit në vijimesi.

Te dhenat aktuale dhe krahasuese janë shprehur në Leke shqiptar, që është monedha raportuese e shoqërisë.

Shenimet e pasqyrave financiare (vazhdim)

2.2 Standarde te emetuara por qe ende nuk kane hyre ne fuqi dhe nuk jane adoptuar

- **Ligji i Ri per Kontabilitetin ne Shqiperi**

Në vijim të punës që po bën qeveria shqiptare në rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar më datë 10 maj 2018 ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” (më poshtë “Ligji i ri për kontabilitetin” ose “Ligji i ri”), i cili shfuqizon ligjin e mëparshëm nr. 9228, datë 29.4.2004. Ligji i ri për kontabilitetin është përafshuar pjesërisht me Direktivën 2013/34 të Bashkimit Evropian dhe qëllimi është përafrimi i plotë i tij në vitin 2028. Ligji i ri hyn në fuqi më datë 1 janar 2019. Aplikimi i Ligjit të ri nuk ka ndikim në pozicionin financiar dhe performancën e Shoqërisë dhe në menyrën e përqitjes së pasqyrave financiare.

Shoqëria ka zgjedhur të mos i implementojë këto standarde, rishikimeve dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Shoqëria parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Entitetit në periudhën e aplikimit fillestar.

- **Përmirësime të SKK 2 Prezantimi i Pasqyrave Financiare**

Ndryshimet në SKK 2 Paraqitja e Pasqyrave Financiare sqarojnë sesa ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme kërkesat ekzistuese të SNK 1. Ndryshimet qartësojnë:

- informacioni i nevojshëm për të identifikuar njësinë ekonomike;
- informacion shtese në lidhje me aktivet e qendrueshme,
- shumat e kompensuara duhet të jepen për vlerën bruto të tyre tek shënime shpjeguese.
- shënime shpjeguese me të detajuara për të ardhurat

Këto përmirësime do të behen efektive nga 1 Janar 2019. Aplikimi i këtyre ndryshimeve nuk do të kenë efekt në Pasqyrat Financiare të Shoqërisë

- **Përmirësime të SKK 9 Kombinimet e Biznesit**

Ndryshimet në SKK 9 Kombinimet e Biznesit shtojnë disa kërkesa në përputhje me Direktivat Bashkimit Evropian. Ndryshimet qartësojnë:

- prezantimin e pjesëmarrjeve në pasqyrat financiare të konsoliduara
- rast kur nuk përgatiten pasqyra të konsoliduara
- lejimi i raportimit në data të ndryshme
- në shënime të pasqyrave financiare të shpjegohen metodat e përdorura për llogaritjen e vlerës së emrit të mirë në kombinimin e biznesit si dhe çdo ndryshim i rëndësishëm i vlerës së tij në raport me vitin paraardhës financiar;
- në pasqyrat financiare të konsoliduara të mëmës të jepet informacion: (a) në lidhje me të dhëna për njësitë ekonomike të përfshira në konsolidim si emri, selia dhe kapitali i investuar tek to nga mëma (b) emrat dhe selinë e regjistruar të njësive ekonomike ku, njësitë e përfshira në konsolidim tek mëma, kanë interesa pjesëmarrëse (c) emrat dhe selinë e regjistruar të njësive ekonomike të konsoliduara në mënyrë proporcionale (d) në lidhje me secilën prej njësive ekonomike ku mëma mban një interes në pjesëmarrje;
- njësia ekonomike mëmë disa shënime shpjeguese të caktuara për rastet kur kjo mëmë është e përjashtuar nga detyrimi për të hartuar pasqyra financiare të konsoliduara.

Këto përmirësime do të behen efektive nga 1 Janar 2019. Aplikimi i këtyre ndryshimeve nuk do të kenë efekt në Pasqyrat Financiare të Shoqërisë

Shenimet e pasqyrave financiare (vazhdim)

2.3 Aktivët afatgjata materiale dhe jo materiale

Aktivët afatgjata materiale dhe jomateriale janë pasqyruar në librat e shoqërisë me koston e tyre historike minus zhvlerësimin e akumuluar.

Normat vjetore të zhvlerësimit të aplikuar janë si më poshtë:

	Normat e zhvlerësimit %	Normat e zhvlerësimit %	Bazë e llogaritjes
Aktivët afatgjata materiale	2018	2017	
Mobilje dhe orëndi	20	20	Vlera kontabel neto
Paisje elektronike	25	25	Vlera kontabel neto
Aktivët afatgjata jo materiale			
Softwares	25	25	Vlera kontabel neto
Te tjera aktive jo-materiale	15	15	Vlera bruto

Vlera kontabel e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale rishikohet për rënie në vlerë kur ndryshimet e rrethanave tregojnë që vlera kontabel mund të mos jetë e rikuperueshme. N.q.s rrethana të tilla ekzistojnë dhe kur vlera kontabel tejkalon vlerën neto të realizueshme, aktivët ose njesitë gjeneruese të parave do të pakesohen në vlerën e tyre të realizueshme dhe humbjet nga rënia e vlerës njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

2.4 Aktivët dhe detyrimet financiare

Aktivët dhe detyrimet financiare konsistojnë teresisht në llogari të arketueshme dhe llogari të pagueshme dhe janë pasqyruar në bilanc bazuar në shumën e faturuar.

Provizionet për borxhet e keqija njihen kur shumën konsiderohen të pambledhshme. Provizionet për borxhet e keqija është vlera e llogaritur nga drejtimi për të absorbuar humbje të mundshme në të ardhmen për llogari të arketueshme ekzistuese që mund të behen të pambledhshme si pasoje e kushteve ekonomike ekzistuese, rreziqeve të qenesishme dhe të cilësive të klienteve dhe faktoreve të tjera relevante, që sigurojnë njohjen aktuale. Vlera e humbjeve specifikisht e identifikuar (psh kliente të klasifikuar si të dyshimta dhe të humbur) njihen si shpenzime dhe zbriten nga totali i llogaritës së arketueshme për atë klient si provizion për borxhet e keqija.

2.5 Mjetet monetare dhe ekuivalente

Mjetet monetare përfshijnë para të mbajtura në bankat vendase dhe para në arke në monedhe vendase dhe të huaj dhe paraqiten me kosto.

2.6 Transaksionet në monedhe të huaj

Transaksionet në monedhe të huaj perkthehen në LEK dhe regjistrohen duke përdorur kursin zyrtar në datën e transaksionit. Mjetet monetare dhe zerat e tjera jomonetare në bilanc të shprehur në monedhe të huaj janë perkthyer në LEK me kursin zyrtar të këmbimit në datën e bilancit. Diferencat e këmbimit që rezultojnë kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të shoqërisë.

Kursi zyrtar i këmbimit për monedhat kryesore për perkthimin e zerave të bilancit të shprehur në monedhe të huaj paraqiten si vijon (në LEK):

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
1 EUR	123.42	132.95
1 USD	107.82	111.10

Shenimet e pasqyrave financiare (vazhdim)

2.1 Të ardhurat dhe shpenzimet

Te ardhurat njihen ne masen qe eshte e mundshme qe perfitimet e ardhshme ekonomike do te hyjne ne shoqeri dhe keto perfitime mund te maten ne menyre te besueshme

Shpenzimet njihen ne pasqyren e te ardhurave ne momentin kur ato ndodhin.

2.7 Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin eshte llogaritur ne perputhje me legjislacionin shqiptar per tatimin mbi fitimin. Tatimi mbi fitimin njihet ne pasqyren e te ardhurave me perjashtim te zerave qe njihen direkt ne kapital ose ne te ardhurat e tjera gjithepershires.

Tatim mbi fitimin eshte tatim fitimi i pritshem mbi te ardhurat e tatueshme per vitin, duke perdorur normat e tatimit ne daten e raportimit, dhe cdo korigjim te tatimit te pagueshem per vitet e kaluara.

Tatim fitimi llogaritet me 15 % per vitin 2018 (31.12.17: 15%) mbi fitimin e tatueshem.

2.8 Përfitimet e pas daljes në pension dhe planet e pensionit

Shoqeria paguan vetem kontributet per sigurimet e detyrueshme shoqerore qe sigurojne pension per punonjesit. Qeveria shqiptare eshte pergjegjese per caktimin e minimumit te kontributit per sigurimet shoqerore ne Shqiperi sipas nje plani pensioni bazuar ne kontribute. Kontributet e shoqerise ne planin e pensionit jane pasqyruar ne pasqyren e te ardhurave kur ndodhin.

2.9 Huamarrjet

Huamarrjet njihen fillimisht me vlere te drejte, minus koston e transaksionit te ndodhur. Huamarrjet njihen me vone me koston te amortizuar. Cdo diference ndermjet parave te marra (minus koston e transaksioneve) dhe vleres perfundimtare do te njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve gjate periudhes se huamarrjes duke perdorur metodën e interesit efektiv.

2.10 Kapitali i aksionerëve

Kapitali i aksionerëve përbëhet nga mjetet monetare kontribuar nga themeluesit e shoqerise. Kapitali i aksionerëve kontabilizohet në shumën përkthyer në monedhën vendase të valutës së huaj të kontribuar, duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit

2.11 Provigjonet

Një provgjon njihet kur Shoqeria ka një detyrim aktual si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe është e mundur që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin, dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet për shumën e detyrimit. Provigjonet rishikohen në cdo datë të bilancit të pozicionit financiar dhe rregullohet duke reflektuar vlerësimin më të mirë aktual. Kur efekti i vlerës në kohë të parës është material, shuma e provigjonit është vlere e tanishme e shpenzimeve që pritet të jetë e nevojshme për të shlyer detyrimin. Provigjonet nuk njihen për humbjet e ardhshme operative.

Shenimet e pasqyrave financiare (vazhdim)

2.12 Angazhimet dhe detyrime te kushtezuara

Detyrimet e kushtezuara nuk njihen ne pasqyrat financiare. Ato paraqiten vetem ne shenimet shpjeguese, perjashto rastet kur mundesia e nje daljeje te burimeve qe perfshijne perfitime ekonomike eshte e larget. Aktivet e kushtezuara nuk njihen ne pasqyrat financiare por paraqiten ne shenime kur nje hyrje e perfitimeve ekonomike eshte e mundur. Vlera e nje humbje te kushtezuar njihet si provizion nqs eshte e mundshme qe ngjarje te ardhshme do ta konfirmojne ate, nje detyrim i lindur ne daten e bilancit kontabel dhe nje vleresim i arsyeshem i vleres se humbjes mund te behet.

2.13 Transaksione me palet e lidhura

Palet e lidhura jane ato ku nje pale kontrollohet nga tjetra ose ka influence te rendesishme ne marrjen e vendimeve financiare ose te biznesit te pales tjetere.

2.14 Ngjarje pas periudhes se raportimit

Ngjarjet pas dates se bilancit qe sigurojne informacion shtese per pozicionin e shoqerise ne daten e pasqyres se pozicionit financiar (ngjarje rregulluese) do te reflektohen ne pasqyrat financiare. Ngjarjet pas dates se bilancit qe nuk jane ngjarje rregulluese do te paraqiten ne shenimet e pasqyrave financiare kur jane materiale.

3. Mjetet monetare

Mjetet monetare jane si vijon:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
<u>Arka</u>		
- ne monedhe vendase	113,982	99,391
- ne monedhe te huaj	-	-
	<u>113,982</u>	<u>99,391</u>
<u>Llogari rrjedhese ne banka</u>		
- ne monedhe vendase	2,384,592	4,756,277
- ne monedhe te huaj	31,411,680	40,884,557
	<u>33,796,273</u>	<u>45,640,834</u>
Totali i mjeteve monetare	<u><u>33,910,255</u></u>	<u><u>45,740,225</u></u>

4. Llogari te arketueshme

Llogarite e arketueshme perbehen nga balanca me kliente vendas.

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Kliente pale te lidhura	102,141,596	102,141,596
Kliente te ndryshem	4,244,986	88,653,586
Llogari te arketueshme, neto	<u><u>117,841,500</u></u>	<u><u>190,795,182</u></u>

Drejtimi i Kompanise beson se risku i mosarketimit eshte minimal dhe nuk parashikohet borxh i keq.

5. Te tjera te drejta te arketueshme

Te tjera te arketueshme jane detajuar si me poshte:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Marredhenie me pale te lidhura	74,837,576	74,709,458
Parapagime per punime Fufarma	6,209,262	5,878,656
Tatim fitimi i parapaguar	1,777,185	1,777,185
Tatim Fitimi	1,833,160	-
Tvah kreditore	257,372	-
Te tjera	375,000	375,000
Totali	<u><u>85,289,555</u></u>	<u><u>82,740,299</u></u>

6. Inventari

Inventari eshte pasqyruar si me poshte:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Materiale te tjera	5,198,532	1,280,063
Apartamente te Gatshme	103,134,133	113,063,754
Totali	<u><u>108,332,665</u></u>	<u><u>114,343,816</u></u>

7. Aktivet afatgjata materiale

	Ndertesa	Makineri dhe paisje	Mjetet e transportit	Paisje zyre	Total
Kosto					
Me 1 Janar 2018	125,553,921	6,571,105	24,073,028	5,348,252	161,546,306
Shtesat	187,889	-	7,071,120	439,440	7,698,449
Pakesimet	-	-	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2018	125,741,810	6,571,105	31,144,148	5,787,692	169,244,755
Zhvleresimi					
Me 1 Janar 2018	-21,602,642	-6,104,391	-22,578,569	-	-54,485,347
Zhvleresimi i vitit	-5,198,955	-93,343	-652,448	-203,433	-6,148,179
Me 31 Dhjetor 2018	-26,801,597	-6,197,734	-23,231,017	4,403,178	-60,633,526
Vlera neto kontabel 1 Janar 2018	103,951,279	466,714	1,494,459	1,148,507	107,060,959
Vlera neto kontabel 31 Dhjetor 2018	98,940,213	373,371	7,913,131	1,384,514	108,611,229

	Ndertesa	Makineri dhe paisje	Mjetet e transportit	Paisje zyre	Total
Kosto					
Me 1 Janar 2017	94,562,870	6,571,105	24,073,028	5,092,564	130,299,567
Shtesat	3,872,970	-	-	255,688	4,128,658
Rivleresimet	27,118,081	-	-	-	27,118,081
Me 31 Dhjetor 2017	125,553,921	6,571,105	24,073,028	5,348,252	161,546,306
Zhvleresimi					
Me 1 Janar 2017	-16,492,935	-5,987,713	-22,204,954	-3,923,655	-48,609,257
Zhvleresimi i vitit	-5,109,707	-116,678	-373,615	-276,090	-5,876,090
Pakesimet	-	-	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2017	-21,602,642	-6,104,391	-22,578,569	-4,199,745	-54,485,347
Vlera neto kontabel 1 Janar 2017	78,069,935	583,392	1,868,074	1,168,909	81,690,310
Vlera neto kontabel 31 Dhjetor 2017	103,951,279	466,714	1,494,459	1,148,507	107,060,959

8. Investime ne shoqëri të tjera

Investimet ne shoqëri te tjera jane pasqyruar si me poshte:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Investime te Fuente Dynamics shpk (Kosove)	29,925,600	-
Investime te Fassa&Berberi Sh.a	5,200,000	5,200,000
Totali	35,125,600	5,200,000

9. Furnitore

Furnitoret perfshijne kryesisht detyrimet kundrejt furnitoreve vendas.

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Furnitore vendas	118,973,092	224,301,527
Furnitore te huaj	390,417	390,417
Furnitore neto	119,363,509	224,691,944

10. Paga të pagueshme dhe të ngjashme

Detyrimet për pagat dhe detyrime të ngjashme :

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Paga e shperblime	1,168,309	1,019,024
Sigurime shoqërore e shëndetsore	253,036	312,760
Totali i pagave të pagueshme dhe të ngjashme	1,421,345	1,331,784

11. Te tjera te pagueshme

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Detyrime te ndryshme	609,563	609,563
Tatim mbi te ardhurat personale	126,044	79,001
TVSH e pagueshme	-	288,088
Tatim mbi fitimin per tu paguar	-	1,657,350
Totali	735,607	2,634,001

12. Huamarrje afat gjatë

Huamarrjet afatgjate jane detajuar si meposhte:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
<u>Huamarrje afat-gjate</u>		
Isuf Berberi (pa afat)	37,545,249	37,545,249
Hua nga I.Berberi (2 vjet)	30,855,000	-
	68,400,249	37,545,249
Minus: pjesen afat-shkurter te kredise afat-gjate	-	-
Totali huamarrje afat-gjate	68,400,249	37,545,249

13. Kapitali dhe rezervat

Kapitali

Me 31 Dhjetor 2018, sipas Qendres Kombetare te Regjistrimit (QKR) totali i kapitalit te regjistruar eshte 270,000,000 Leke.

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017	%
Isuf Berberi	270,000,000	136,800,000	100
Totali	270,000,000	136,800,000	100

Rezerva te tjera

Balanca e rezerva te tjera eshte krijuar nga fitimi i pashperndare i viteve te meparshme dhe nga rivleresimi i apartamenteve, dhe ne 31 Dhjetor 2018 eshte 7,874,090 Leke (2017: 120,439,379 Leke)

14. Te ardhura nga veprimtarite e shfrytezimit

Shoqeria ka vazhduar edhe gjate vitit 2018 te kryeje punime. Situacionet nga keto punime jane pasqyruar si me poshte:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Situacione punimesh godina Fufarma	37,145,903	47,330,653
Shitje Apartamenti	20,471,302	108,444,794
Shitje materialesh	5,398,762	-
Situacione punimesh Zyra	156,574	2,528,557
Totali	63,172,541	158,304,004

15. Te ardhura te tjera

Te ardhurat e tjera jane detajuar si me poshte

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Te ardhura nga qeraja	16,380,408	17,174,858
Te tjera	-	753,765
Totali	16,380,408	17,928,623

16. Kostoja e materialeve te konsumuara

Kostoja e materialeve eshte detajuar si me poshte:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Gendja ne fillim	114,343,816	195,952,656
Shpenzime blerje materiale e produkte	12,953,106	5,920,462
Transport	603,498	3,296,751
Gendja ne fund	-108,332,665	-114,343,816
Kostoja e materialeve	19,567,755	90,826,052
Situacione punimesh	17,428,815	29,594,152
Totali	36,996,570	120,420,204

17. Shpenzime personeli

Shpenzimet per personelin perfshijne si vijon:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Paga dhe shperblime	14,203,271	13,584,050
Sigurimet shoqerore dhe shendetesore	2,030,680	2,092,125
Totali	16,233,951	15,676,175

18. Shpenzime administrative dhe te tjera

Shpenzimet administrative dhe të tjera perbehen nga:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Ruajtje objekti	2,970,000	2,556,000
Taksa nacionale dhe lokale	1,152,306	838,902
Sherbime Profesionale	990,244	905,058
Transferim Udhetim Dieta	867,752	-
Mirembajtje dhe riparime	361,540	768,721
Telekomunikacion	342,151	260,168
Energji, uje	280,575	210,095
Te tjera	258,631	19,807
Kanceleri	93,616	121,357
Penalite te dhe gjoba	6,027	9,937
Totali	7,322,842	5,690,043

19. Te ardhurat/(shpenzimet) financiare

Te ardhurat/(shpenzimet) financiare perfshijne fitimet dhe humbjet e realizuara apo te perealizuara nga kurset e kembimit, te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat, dhe te tjera te ardhura financiare si vijon:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Fitime (humbje) nga kurset e kembimit	-2,727,782	-2,100,216
Fitime (humbjet) neto nga kurset e kembimit	-2,727,782	-2,100,216
Te ardhura (shpenzime) financiare	(95,013)	(68,065)
Te ardhurat (shpenzimet) neto financiare	(95,013)	(68,065)
Totali i te ardhurave/(shpenzimeve) financiare neto	2,822,796	-2,168,281

20. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit fitimit rakordon me fitimin kontabël per vitin 2018 dhe 2017 si me poshte:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
1 Fitimi/(Humbja) para tatimit	10,028,613	26,401,834
2 Shpenzime te panjohura	12,840	12,961
3 Gjoba e penalite te	6,027	9,937
5 Fitimi / (humbje) e tatueshme (1+2+3+4)	10,047,480	26,424,732
6 Humbje te mbartura (-)	-	0
7 Fitimi i tatueshem	10,047,480	26,424,732
Norma e tatimit mbi fitimin	15%	15%
8 Shpenzim tatim fitimi	1,507,122	3,963,710
9 Tatim fitimi i parapaguar	3,340,282	2,306,360
10Tatim fitimi i arketueshem (i pagueshem)	1,833,160	-1,657,350

21. Gjykimet dhe cmuarjet e rendesishme kontabel

Ne aplikimin e politikave kontabel te Kompanise, qe pershkruhen ne Shenimin nr 2, drejtimit i kerkohej qe te beje gjykime, cmuarje, dhe supozime per vleren kontabel te aktiveve dhe detyrimeve qe nuk jane te qartesisht te dukshme nga burime te tjera. Cmuarjet dhe supozimet e lidhura me to jane te bazuara ne eksperiencen historike dhe faktore te tjere qe konsiderohen te rendesishem. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto cmuarje.

Cmuarjet dhe supozimet e lidhura me to jane rishikuar ne menyre te vazhdueshme. Ndryshimet ne cmuarjet kontabel do te njihen ne periudhen ne te cilen cmuarja eshte rishikuar nqs rishikimi ndikon vetem ate periudhe ose ne periudhen e rishikimit dhe ne periudha te ardhshme nqs rishikimi ndikon periudhen aktuale dhe ato te ardhme.

Pasiguria ne gjykime

Zhvleresimi i aktiveve jofinanciare

Humbjet nga zhvleresimi do te njihen ne vleren ne te cilen vlera kontabel e aktiveve ose e njesise gjeneruese te parase tejkalon vleren e rikuperueshme. Kur percaktohet vlera e rikuperueshme, drejtimi vlereson cmimet e pritshme dhe flukset e parase nga cdo njesi gjeneruese e parase dhe percakton nje norme interesi te pershtatshme kur llogaritet vlera aktuale e ketyre flukseve te parase.

Zhvleresimi i aktiveve financiare

Zhvleresimi i llogarive te arketueshme

Kompania llogarit zhvleresimin per llogarite e arketueshme bazuar ne humbjet e vleresuara qe rezultojne nga paaftesia e klienteve per te bere pagesat e kerkuara. Vleresimi i mjaftueshmerise se humbjes nga zhvleresimi per llogarite e dyshimta eshte bazuar ne analizen e vjetersise te llogarive te arketueshme dhe eksperiencen historike te cregjistrimit, cilesine e klientit dhe ndryshimet ne termat e pageses se klientit. Kjo perfshin supozime per sjelljen e ardhshme te klientit dhe mbledhjet e ardhshme te parave. Nqs kushtet financiare te klientit perkeqsohen, eliminimet aktuale te llogarive te arketueshme ekzistuese mund te jene me te larta se sa priteshin dhe mund te kalojne nivelin e humbjeve nga zhvleresimi te njohura deri tani.

Jeta e dobishme e aktiveve te amortizueshme

Drejtimi rishikon ne menyre te vazhdueshme jeten e dobishme te aktivete te mbajtura me kosto te amortizuar ne cdo date te pasqyres se pozicionit financiar. Drejtimi vlereson se jeta e dobishme e aktiveve reflekton dobishmerine e pritur te ketyre aktiveve. Vlera e mbetur e ketyre aktiveve eshte analizuar ne Shenimin 7. Rezultatet reale mund te ndryshojne per shkak te konsumimit teknologjik.

Inventari

Inventari eshte paraqitur me vleren me te ulet midis kostos dhe vleres se realizueshme neto. Gjate percaktimit te vleres se realizueshme neto, drejtimi merr parasysh evidencat me objektive te disponueshme per kryerjen e vleresimeve.

22. Angazhimet dhe detyrime te kushtezuara

Angazhime

Shoqeria nuk ka angazhime materiale te nenkontraktuara ne daten e pasqyres se pozicionit financiar te cilat te mos jene reflektuar ne pasqyrat financiare.

Detyrime tatimore

Librat dhe te dhenat kontabel per vitet financiare qe perfundojne me 31 Dhjetor 2018 nuk jane audituar nga autoritetet tatimore. Si rrjedhim, detyrimet tatimore te Shoqerise mund te mos konsiderohen te finalizuara.

Ceshtje gjyqesore

Ne daten e mbylljes se pasqyrave financiare 31 Dhjetor 2018, nuk ka asnje ceshtje gjyqesore te ngritur kunder Shoqerise.

23. Ngjarje pas dates se raportimit

Mbas dates 31 Dhjetor 2018 – date e raportimit dhe e aprovimit te pasqyrave financiare, nuk ka ngjarje materialisht te rendesishme qe te mund te ndikojne ne keto pasqyra financiar

OTTO-AL

General Construction & Mineral Processing

Rruga Faik Konica, Ndertesa nr.6, Hyrja nr.7, 1010

Tel.: +355 4 2468473
E-mail: info@otto-al.com
Tirana / ALBANIA

Tiranë, më 15.03.2019

VENDIM

Datë 15.03.2019

I emërimit të Audituesit Ligjor

Sot më datë 15.03.2019, Ortaku i vetëm i shoqërisë “OTTO-AL” shpk,

VENDOSI:

Të emërojë si Auditues të Pasqyrave Financiare TPA Albania shpk, me nr. Regj. 381 dhe Nipt L316190120.

Ortaku i vetëm i shoqërisë

“OTTO-AL” SHPK

ISUF BERBERI

